

VENDIM
Nr. 682, datë 11.9.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 480, DATË 26.6.2026, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIFORCIMIT TË NJËSIVE TË BANIMIT NË
NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË KRUJË E KURBIN, DHE CAKTIMIN E
BASHKIVE KRUJË E KURBIN SI NJËSI ZBATUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të nënndarjeve “i” e “iii”, të shkronjës “b”, të nenit 13, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, dhe të ligjit nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit nr. 480, datë 26.6.2026, të Këshillit të Ministrave “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e riforcimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), në bashkitë Krujë e Kurbin, dhe caktimin e bashkive Krujë e Kurbin si njësi zbatuese”, bëhen këto ndryshime:

a) Në paragrafin e parë, vlera “... 300 618 237, 34 (treqind milionë e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e shtatë presje tridhjetë e katër) lekë ...” zëvendësohet me “... 267 872 232, 84 (dyqind e gjashtëdhjetë e shtatë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e dyqind e tridhjetë e dy presje tetëdhjetë e katër) lekë ...”;

b) Në shkronjën “a”, vlera “... 196 476 027 (njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë milionë e katërqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e njëzet e shtatë) lekë ...” zëvendësohet me “... 163 730 022,50 (njëqind e gjashtëdhjetë e tre milionë e shtatëqind e tridhjetë mijë e njëzet e dy presje pesëdhjetë) lekë ...”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Bashkia Krujë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama